



**UNIVERSITETI “UKSHIN HOTI” - PRIZREN**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**  
**PROGRAMI FILLOR**

## SYLLABUSI I LËNDËS

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	<b>Fakulteti i Edukimit, Univ. “Ukshin Hoti” – Prizren</b>
Titulli i lëndës:	<b>Metodologjia e edukimi fizik</b>
Programi	<b>Fillor</b>
Niveli:	<b>Bachelor</b>
Statusi lëndës:	<b>Obligative</b>
Viti i studimeve:	<b>IV - Sem. VII - 2021-2022</b>
Numri i orëve në javë:	<b>3+2</b>
Vlera në kredi – ECTS:	<b>7</b>
Koha / lokacioni:	<b>10:00-12:15 – 13.00-15.15</b>
Mësimdhënësi i lëndës:	<b>Prof.Ass.Dr. Lulzim Ibri</b>
Detajet kontaktuese:	<b>+383 44 470 003</b> <a href="mailto:lulzimibri@gmail.com">lulzimibri@gmail.com</a> <a href="mailto:lulzim.ibri@uni-prizren.com">lulzim.ibri@uni-prizren.com</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Përmes aplikimit të kësaj lënde në procesin e mësimdhënies mundësohet organizimi, zhvillimi dhe rrjedha e mësimin në nivelin më të lartë profesional, duke iu përshtatur kushteve e kërkesave metodiko-didaktike. Trajtohen format organizative të punës në kuadër të edukimit fizik, ndikimi i aktiviteteve fizike në organizëm, duke përfshirë eshtrat, muskujt, nyet, sistemin kardiovaskular, respirator, parimet themelore të mësimdhënies së edukimit fizik, metodat mësimore, mjetet dhe rekuizitat, strukturën e orës, planifikimin e aktiviteteve në fushën e edukimit fizik, rëndësinë e edukimit fizik etj.
<b>Qëllimet e lëndës:</b>	Të aftësoj studentet, mësuesit e ardhshëm që të udhëheqin të pavarur me të gjitha programet dhe format organizative të punës në Ed. Fizik. Të studiojnë ligshmëritë dhe karakteristikat e përgjithshme shkencore në Ed. Fizik. Në praktikën pedagogjike të jenë në gjendje që me sukses tu përgjigjen detyrave profesionale.
<b>Rezultatet e pritura të studentëve:</b>	<b>Në fund studentët do të arrijnë që:</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Të formojnë botëkuptimin e drejtë profesional.</li> <li>- Të planifikojnë dhe aplikojnë mësimin praktik e teorik në edukim fizik dhe të përpunojnë materialin e lëndës.</li> <li>- Të aplikojnë planprogramet, planifikojnë temat.</li> <li>- Të njihen me ndikimin e aktiviteteve fizike në organizëm (eshtra, muskuj, nye, sistemin kardiovaskular, respirator) etj.</li> <li>- Të njihen dhe të aftësohen të praktikojnë parimet themelore të Edukimit fizik.</li> <li>- Të njihen dhe të zbatojnë metodat mësimore të Edukimit fizik.</li> <li>- Të aftësohen të planifikojnë punën edukativo arsimore në kuadër të aktiviteteve të Edukimit fizik.</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Të mësojnë që të aplikojnë lojra e gara sportive, si dhe të njihen me rëndësinë e lojës në Edukimin fizik.</li> <li>- Të dinë ti përdorin mjetet, paisjet, veglat e rekuizitat.</li> <li>- Të dinë si bëhet vlerësimi dhe të dinë të zbatojnë ecuri të ndryshme të vlerësimit.</li> <li>- Të dinë si të sillen me fëmijët, me prindërit e tyre dhe me kolegë gjatë ushtrimit të veprimtarisë edukativo-arsimore.</li> </ul>
--	--

**Kontributi në ngarkesën e studentit  
(gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)**

<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	<b>3</b>	<b>1-15</b>	<b>45</b>
Ushtrime teorike/laboratorike	<b>2</b>	<b>1-15</b>	<b>30</b>
Punë praktike	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>
Kontaktet me mësimdhënësin/konsult.	<b>1</b>	<b>1-15</b>	<b>15</b>
Ushtrime në teren	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>
Kollokfiume, seminare	<b>3</b>	<b>2-2</b>	<b>6</b>
Detyra të shtëpisë	<b>1</b>	<b>1-6</b>	<b>6</b>
Koha e studimit vetanake të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	<b>2</b>	<b>1-15</b>	<b>30</b>
Përgatitja përfundimtare për provim	<b>2</b>	<b>1-15</b>	<b>30</b>
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuis, provim final)	<b>3</b>	<b>1-3</b>	<b>9</b>
Projektet, prezantimet ,etj	<b>3</b>	<b>1-3</b>	<b>9</b>
<b>Totali</b>			<b>180</b>

<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Në procesin e mësimdhënies zbatohet metodologji bashkëkohore. Format e ndryshme të ligjërimit të modifikuar, punë e pavarur e studentëve sipas formave bashkëkohore të bashkëpunimit. Ligjerata teorike. - Ushtrime. Punë në grupe. Diskutime. Përsëritje sipas nevojës. - Provim me shkrim.
-------------------------------------	--

<b>Metodat e vlerësimit:</b>	<p>Përcjellja e punës së gjithëmbarshme të studentëve bëhet në mënyrë të vazhdueshme përmes protokollëve të vëzhgimit, diskutimeve të mbështetura në burimet relevante dhe vlerësimin e parë dhe të dytë intermediar. Studentët varësisht nga niveli i angazhimit të tyre në punën e drejtëpërdrejtë arsimore kanë mundësi të grumbullojnë deri në 100 pikë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Angazhimet e studentëve me detyra.....10%</li> <li>• Punimi seminarik:.....10%</li> <li>• Punimi intermediarë I. ....15%</li> <li>• Punimi intermediarë II. ....15%</li> <li>• Provimi final me shkrim dhe me gojë..... 50%</li> <li>• <b>Total</b> .....100%</li> </ul>
------------------------------	--

<b>Literatura</b>	
<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Prof..Hasangjekaj B:1998, Metodika e Edukimit fizik, Prishtine, 1998</li> <li>2. Daci J &amp; Belliu V: Metodika e edukimit fizik, Tiranë 2000</li> <li>3. Subashi G &amp; Daci J: Didaktika e edukimit fizik Tirane, 2004</li> <li>4. Krasniqi F: Metodika e edukimit fizik I dhe II, Prishtine 2006</li> <li>5. Elshani Qazim: Metodika e edukimit fizik, Prishtine 2018</li> </ol>
<b>Literatura shitesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. T. Bompaa: Theory and methodology of education, Ilionis,USA, 2000</li> <li>2. Polloshka N: Edukimi fizik e shendetesor, Prishtine, 1984</li> <li>3. Polloshka N: Edukata fizike me metodike, Prishtine, 1984.</li> <li>4. Polloshka N: Shkaqet e deformiteteve trupore, Prishtine, 1985</li> <li>5. Grup autoresh: Metodika e mesimesh, Tirane 1999</li> </ol>
<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>	
<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<b>Java e parë:</b> <i>Aktiviteti praktik:</i>	Koncepte, nocione, përmbajtje dhe terminologji <i>Lartë në tavan, poshtë në dysheme</i>
<b>Java e dytë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Aktiviteti fizik, lëvizja dhe sporti në edukimin fizik – benefitet zhvillimore dhe shëndetësore. Ushtrime: Ecjet dhe vrapimet në forma të ndryshme, rreshti dhe kolona.
<b>Java e tretë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Veçoritë e aftësive fizike dhe motorike të fëmijëve, sipas moshës dhe gjinisë. Ushtrime: Kercimet dhe kapërcimet.
<b>Java e katërt:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Format metodike-organizative të punës në orën mësimore si dhe Metodatat dhe Parimet mësimore në EF Ushtrime Hedhjet - kapjet.
<b>Java e pestë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Format tjera organizative të punës në shkollë dhe jashtë shkollës si dhe Detyrat edukative-arsimore dhe biologjiko-shendetesore në EF. Ushtrime: Zvaritjet dhe perbirimet .
<b>Java e gjashtë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Loja, rëndësia, vlerat dhe klasifikimi i lojërave në edukimin fizik Ushtrime: Ngritjet dhe bartjet.
<b>Java e shtatë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Vlerësimi i parë intermediar Teori: Inteligjenca kinestetike Ushtrime: Përbirimet dhe ngjitjet
<b>Java e tetë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Edukimi fizik dhe shëndeti në Kurikulën shkollore. Ushtrimet: Varrjet dhe lëkundjet.
<b>Java e nëntë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Programimi dhe planifikimi në edukimin fizik, dhe përgatitja me shkrim për orën mësimore. Ushtrimet: Terheqjet dhe shtytjet
<b>Java e dhjetë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Ora mësimore e EF, struktura dhe karakteristikat e sajë. Ushtrime: Rrokullisjet dhe rënjet
<b>Java e njëmbëdhjetë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Masat organizative, higjienike dhe shkaqet e deformiteteve Ushtrime: Lojrat elementare pa dhe me rekuizita.
<b>Java e dymbëdhjetë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Ndikimi i aktiviteteve fizike në organizmin e nxenesve. Ushtrime: Kompleksi i ushtrimeve të formimit - pa dhe me rekuizita.
<b>Java e trembëdhjetë:</b>	Vlerësimi i dytë intermediar Teori: Mjetet, Rekuizitat Hapësirat, Veglat, Pajisjet, Asistimi, ruajtja ndihma

<i>Aktiviteti praktik</i>	dhe sigurimi i nxenesve në orën mesimore të EF <i>Ushtrime: Zhvillimi i një ore, të zgjedhur nga studentët me kompleks të ushtrimeve të formimit - pa dhe me rekuizita</i>
<b>Java e katërbëdhjetë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Evidenca dhe vlerësimi në Edukimin Fizik fillor Ushtrime: Lojrat elementare me top.
<b>Java e pesëmbëdhjetë:</b> <i>Aktiviteti praktik</i>	Teori: Vlerësime dhe prezentime të punës së pavarur të studentëve <i>Ushtrime: Zhvillimi i një ore, të zgjedhur nga studentët me kompleks të ushtrimeve të formimit - pa dhe me rekuizita</i>

#### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

##### **Studentët janë të obliguar:**

- Të respektojnë orarin e ligjëratave dhe të jenë të vëmendshëm në orën mesimore.
- Ti përmbahet të gjitha rregullave edukativo-arsimore.
- Të jenë të përgaditur për ligjëratë duke qenë të pajisur me librin përkatës dhe fletoren për shënime.
- Të jenë pjesëmarrës aktiv në ligjëratë, (meqenëse libri i paraparë për zhvillimin e lëndës, është mjet i cili temat kryesisht i trajton në formë të ushtrimeve, dhe si i tillë kërkon bashkëpunim të vazhdueshëm, në mes të mësimdhënësit, studentëve dhe librit).
- Në respekt të kolegëve të tyre studentë, ata duhet t'i ndalojnë telefonat personal gjatë mësimt.
- Studenti është i obliguar të paraqes dhe posedoj ID kartelën në në testin me shkrim dhe atë me gojë.

**Shënim:** - Pjesëmarrja është parakusht për studentët që dëshirojnë të fitojnë njohuri të duhur të këtij kursi. Studentët që ndjekin rregullisht kursin do të jetë në gjendje të marrin pjesë në mënyrë aktive në klasë, duke dhënë kontributin e tyre konkret gjatë ligjëratave interaktive dhe gjatë ushtrimeve. Prandaj, kontributi i tyre për pjesëmarrje dhe të mësuarit si dhe realizimi i detyrave të tyre do të vlerësohen gjatë gjithë semestrit, në përqindje në bazë të kriterëve të përcaktuara paraprakisht.

**Prof.Ass.Dr. Lulzim Ibri**